

VENDIM
Nr.655, datë 29.9.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.1.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë sipas lidhjes nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

2. Lidhja nr.3, që përmendet në pikën 6, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paragrafi i dytë, i pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

““Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët” në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë” përfitojnë një shtesë, për “kushte pune”, 10 000 (dhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore, të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës. Përfshihen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare:

- nga data 1 korrik 2007, për efekt të ndryshimit të lidhjes nr.3;

- nga data e emërimit të nëpunësve, për përcaktimet që lidhen me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AGJENCINË KOMBËTARE TË

SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit.	II-a	10.050	2%		100.500	20.000
Drejtor drejtorie, në drejtorinë e përmbajtjes.	II-b	10.050	2%		84.000	15.000
Drejtor drejtorie, në drejtoritë mbështetëse.	II-b	10.050	2%		84.000	0
Përgjegjës sektori, në sektorët e përmbajtjes.	III-a/1	10.050	2%		55.000	20.000
Përgjegjës sektori, në sektorët mbështetës.	III-a/1	10.050	2%		55.000	0
	III-b	10.050	2%		49.000	0
Specialist, në sektorët, apo drejtoritë e përmbajtjes.	III-b	10.050	2%		49.000	25.000
Specialist, në sektorët, apo drejtoritë mbështetëse.	IV-a	10.050	2%		37.450	0
	IV-b	10.050	2%		25.850	0

Lidhja nr.3

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
-----------	------------------------------------	--------------------

Titullar i institucionit.	Profesor.	30.000
	Profesor i asociuar.	25.000
Zv/titullar i institucionit, drejtor/drejtore në institucion.	Doktor i Shkencave.	20.000
	Doktor i Shkencave (doktoraturë e mbrojtur në vendet perëndimore).	25.000
Përgjegjës sektori; anëtar i organit drejtues; specialist.	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë. Studime specializuese afatgjata.	10.000
	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë (diplomuar në vendet perëndimore).	20.000